MISIONI SHQIPTAR
E Lumja Nënë Tereza

Blessed Mother Teresa Albanian Mission
739 Browns Line, Etobicoke, Ontario M8W 3V7
Tel. 416 503 4509 dhe **647 558 9382**
www.misioninenetereza.com

Çdo të dielë në orën 12:30 Rruzarja dhe Mesha Shenjte

Falja

6 Mars 2016

Në atë kohë, të gjithë tagrambledhësit dhe mëkatarët i afroheshin Jezusit për ta dëgjuar. Farisenjtë e skribët nynykatnin: "Ky i pranon mëkatarët – thoshin – dhe po ha me ta." Atëherë Jezusi u tregoi këtë shëmbëlltyrë: "Një njeri kishte dy djem. Djali i vogël i tha t'et: 'Babë, ma jep pjesën e pasurisë që më takon!' Ai ua ndau pasurinë. Mbas pak ditësh, djali i vogël mblodhi çka pati dhe shkoi në dhe të largët e atje e shkapërderdhi pasurinë e vet duke jetuar i dhënë pas vesesh. Kur shpenzoi gjithçka pati, u bë zi e madhe buke në atë vend e djali filloi ta sprovoi skamjen. Atëherë shkoi e u lidh rrogëtar te një njeri i atij vendi. Ky e dërgoi në toka të veta t'i ruajë thitë. E dëshironte ta mbushte së paku ndonjë herë barkun me kokrra çiçibunesh që hanin thitë, por askush nuk ia jepte. Atëherë i erdhën mendtë e thoshte: 'Sa mëditësve tim atë u tepron buka, kurse unë këtu po vdes urie! Do të çohem e do të shkoj tek im atë e do t'i them: O atë, rashë në mëkat kundër qiellit e ndaj teje! Nuk jam më i denjë të quhem yt bir; më prano si një ndër rrogëtarët e tu.'
U çua dhe e mori rrugën të kthehet tek i ati. Ndërsa ende ishte larg, i ati e pa, u ngashërye, u lëshua vrap, e mori ngrykë dhe e puthi. Atëherë i biri i tha: 'O atë, rashë në mëkat kundër qiellit e ndaj teje! Nuk jam më i denjë të quhem yt bir!' Por i ati u tha shërbëtorëve të vet: 'Sillni shpejt petkat më të mirat e veshniani! Viniani unazën në dorë e sandalët në këmbë! Sillni viçin e majur e prenie të hamë e të gëzojmë, sepse ky, im bir, pati vdekur e u ngjall, pati humbur e u gjet!' E filluan të dëfrehen. Djali i tij i madh ndodhi në fushë. Kur u kthye e iu afrua shtëpisë, dëgjoi këngë e valle, thirri një shërbëtor dhe e pyeti ç'ndodhi. Ai i përgjigji: 'U kthye vëllai yt e yt atë e preu viçin e majur pse iu kthye djali shëndosh e mirë.' Ai u zemërua dhe nuk deshi të hyjë brenda.
I ati doli jashtë dhe iu lut. Atëherë ai i tha t'et: 'Qe se unë të shërbej tash sa kohë e kurrë nuk e shkela asnjë urdhër tënd. E ti kurrë s'më dhe as një edh të gostitem me miqtë e mi. Por, kur të erdhi ky – djali yt – që prishi pasurinë tënde me lavire, ti ia preve viçin e majur!' 'Biro – i tha i ati – ti je gjithmonë me mua, e gjithçka kam, është jotja. Porse, u desh të gëzohemi e të ngazëllohemi, sepse ky – vëllai yt – pati vdekur e u ngjall, pati humbur e u gjet'." *Lk 15, 1-3.11-32*

Mesha Shenjte....

Mesha kremtohet çdo të dielë në orën 12:30 pm te Kisha: Our Lady of the Miraculous Medal, **739 BROWN'S LINE, Etobicoke**, M8W 3V7 (Browns Line & Evans Avenue) Phone (416) 255-2721. Kisha ndodhet menjehere mbrapa Slovenia Credit Union. Public transport: Brown's Line at Coules Court North Farside (15 m N) 123. Per me shume informacion shih faqen internet: **www.ourladyofmm.com**

Kalendari liturgjik…

07 Mars	Shen Perpetua dhe Feliçita
08 Mars	Shen Gjoni i Hyjit
09 Mars	Shen Françeska e Romës
10 Mars	40 Martiret e Sebastes
11 Mars	Shen Konstantini

Udha e Kryqit / Stations of the Cross…

Çdo te premte gjate Krezhmeve eshte Udha e Kryqit ne mbremje ne oren 7:45.

Haku Kishes 2016… E kane dhene:

Anton	Tinaj
Arben	Toma
Arben	Pepa
Ardian	Precetaj
Dode	Ndreu
Eduart/Aurel	Avullija
Ferdinand	Grabanica
Fred	Kalaj
Gjelosh	Vushaj
Lek	Kapllaj
Martin	Vuktilaj
Mhill	Ftoni
Nik	Biqi
Nikolin	Vukelaj
Nue	Nikci
Pal	Rranxburgaj
Pjeter/Bep	Dreshaj
Prel	Pepushaj
Sokol	Gashaj
Taulant / Elvis	Gjerkaj
Tonin	Ndoja
Tot	Prekulaj
Zef	Shkreli

Zoti ua shperblefte ne te mira e ua shtofte!

Per Hakun e Kishes: Vini re…

Sikur eshte caktuar me vendim te shumices se anetareve **Haku Vjetor i Kishes** eshte 500 dollare dhe mund te jipet ne cash, check ose me credit card (shih faqen website misioninenetereza.com Donate Now for Blessed Mother Teresa Mission), **ne nje shume te vetme ose pjese pjese** gjate vitit. **Ata te cilet per arsye te ndryshme jane ne veshtiresi te kontaktojne drejperdrejt me famullitarin.**

Krezmimet dhe Kungimi i Pare …

Krezmimet (Confirmation) dhe Kungimi i Parë (First Communion) do te jene **në datën 29 Maj**.

Papa: dhimbje për murgeshat e vrara në Jemen, akt dhune djallëzore

Papa Françesku shpreh dhimbjen e tij të thellë për vrasjen e katër Misionareve të Bamirësisë në Jemen, së bashku me 12 vetë të tjerë, gjatë një sulmi terrorist. Në një telegram, nënshkruar nga sekretari i Shtetit të Vatikanit, kardinali Pietro Parolin, Papa siguron se lutet për familjet e viktimave të këtij "akti të dhunshëm djallëzor e pa pikë kuptimi".

Papa lutet edhe që kjo masakër t'i zgjojë ndërgjegjet, t'i shndërrojë zemrat e t'i frymëzojë të gjitha palët për t'i ulur armët e për të rifilluar rrugën e dialogut. Në emër të Zotit, Françesku u kërkon të gjithëve të heqin dorë nga dhuna, të përtërijnë angazhimin e tyre për njerëzit e Jemenit e, në veçanti, për më nevojtarët, në shërbim të të cilëve ishin Misionaret e vrara të Nënë Terezës. Në përfundim Ati i Shenjtë u jep bekimin apostolik të gjithë atyre, që vuajnë për shkak të dhunës e, posaçërisht, Misionareve të Bamirësisë.

Pope Francis: recognize sinfulness to receive God's mercy

(Vatican Radio) Only if our hearts are open and we recognize ourselves as sinners can we receive God's mercy. That's the message Pope Francis imparted to the faithful gathered for the morning Mass Thursday at the Santa Marta guesthouse.

Commenting on the First Reading from the Book of Jeremiah, the Pope stresses in his Homily that "God is always faithful, for he cannot deny himself" while the people do not listen to His word. Jeremiah therefore tells us the "many things that God has done to attract the hearts of the people," but, the Pope adds, the people remain unfaithful.

If the heart is hardened and closed, God's mercy does not enter. In the Psalms, the Pope adds, we all pray together: 'Hear now the voice of God. Do not harden your hearts! ' The Lord always speaks with us in this way, also with the tenderness of a father who says: 'Return to me with all your heart, for I am compassionate and merciful.' But when the heart is hardened, you don't understand this. God's mercy can only be understood when you are able to open your heart to let it enter. "

Ask forgiveness, do not judge others. Faithfulness to God begins with recognizing our sinfulness. If you acknowledge that you are a sinner, "the heart opens and God's mercy is allowed to enter and you begin to be faithful."

"We ask the Lord for the grace of fidelity. And the first step on this path towards fidelity is to admit you are a sinner," adds Pope Francis. "If you do not feel sinful, you have begun badly. We ask for grace so that our hearts do not harden - that they are open to God's mercy - and for the grace of faithfulness. And when we find ourselves unfaithful, for the grace to ask for forgiveness."

Pope Francis
✔
@Pontifex

May the Lord free us from all temptation that separates us from what is essential in our mission and help rediscover the beauty of faith.

DEAR JESUS,

help me to spread Thy fragrance everywhere I go. Flood my soul with Thy spirit and love. Penetrate and possess my whole being so utterly that all my life may only be a radiance of Thine. Shine through me and be so in me that

every soul I come in contact with may feel Thy presence in my soul. Let them look up and see no longer me but only Jesus. Stay with me and then I shall begin to shine as you shine, so to shine as to be a light to others.

L-MULTI DRAFTING/DESIGN

LEK SELMANI owner

Tel: (416) 471-0475
Fax: (647) 345-4126
E-mail: Lek@Lmultidd.com
www.Lmultidd.com

JU SHËRBEJMË ME PROJEKTE PËR LEJE NDËRTIMI (PERMIT DRAWINGS) NË PROJEKTIM THE DETAJIM NDËRTIMI PER SHTËPI TË REJA, SHTESË SHTËPIJE GARAZHD TË RI, HYRJE TË RE BEJSMENTI, STORES/OFFICES RESTAURANTS DHE ÇDO MODIFIKIM TJETER.



Radio Maria! Degjoje drejtperdrejt live ne www.radiomaria.al +355-69-333-3302 ose MagicJack 484-961-1564